



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	24. 05 2023	3	viti god veç.
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHCK	4402/2023		1110



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.563/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses,ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.563/2023 të datës 27.03.2023 të parashtruar nga grup ankuesish.

me adresë

përballë furrës Aroma në Gjilan, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.563/2023 e datës 27.03.2023, e parashtruar nga ankuesit

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.05/2023 i datës 21.02.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tutje referuar si SKGJK), me datën 13.06.2022 përveç pozitive tjera, ka shpallur Konkursin e brendshëm Nr.02/2022 lidhur me pozitat për: Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika dhe Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjilan, i cili konkurs sipas shkresave të lëndës ka qenë i hapur për aplikim nga data 13.06.2022 deri me datën 20.06.2022.

Sipas regjistrimit të aplikacioneve të pranuar të datës 16.12.2022 të publikuar nga SKGJK lidhur me pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve për një (1)

pozitë në Gjykatën Themelore në Gjilan kanë aplikuar dhe janë përfshirë në listën e ngushtë dhjetë (10) kandidat ndër ta edhe ankuesit:

ndërsa lidhur me pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika për një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Gjilan kanë aplikuar dhe janë përfshirë në listën e ngushtë nëntë (9) kandidat ndër ta edhe ankuesit: ndërsa sipas Njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare me Nr.03/2315 të datës 27.12.2022 lidhur me pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjilan për një (1) pozitë si kandidat i suksesshëm është shpallur me gjithsejtë 374.75 pikë të grumbulluara, ndërsa sipas Njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare me Nr.03/2318 të datës 27.12.2022 lidhur me pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika në Gjykatën Themelore në Gjilan për një (1) pozitë si kandidat i suksesshëm është shpallur me gjithsejtë 377.25 pikë të grumbulluara.

Ankuesit e pa kënaqur me njoftimin mbi përzgjedhjen përfundimtare lidhur me pozitën e lartcekura, me datën 23.01.2023 kanë parashtruar ankesën me Nr.01/103 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.05/2023 të datës 21.02.2023 refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesve të datës 23.01.2023, duke lënë në fuqi Njoftimet me Nr.03/2315 dhe Nr.03/2318 të datës 27.12.2022 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve lidhur me pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika dhe Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Kundër Vendimit KA.nr.05/2022 të datës 21.02.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, ankuesit përmes Postës së Kosovës me datën 23.03.2023 kanë parashtruar ankesë me numër të protokollit 3007/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është pranuar me datën 27.03.2023, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 30.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek SKGJK, ndërsa me datën 10.05.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 05.05.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesve edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve me numër protokollit 3007/2023 të datës 27.03.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e konkursit me Nr.02/2022 të datës 13.06.2022 nga SKGJK; Vendimin me numër KA.nr.05/2023 të datës 21.02.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 10.05.2023 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
Vendimin me numër protokoll 03/2254 të datës 14.12.2022 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit
Gjyqësor i Kosovës; Ankesën e parashtruar nga ankuesit me numër protokoll 01/103 të datës
23.01.2023 drejtuar Komisionit për Zgjidhje e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e Këshillit
Gjyqësor të Kosovës; Konkursin e brendshëm me numër protokoll 03/1211 të datës 13.06.2022 të
shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Përgjigje në ankesë me numër protokoll
03/688 të datës 10.05.2023 të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Njoftimin për zgjedhjen
përfundimtare të konkursit të brendshëm me numër protokoll 03/2315 të datës 27.12.2022 të lëshuar
nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Propozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar
të datës 23.12.2022 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Renditja përfundimtare
e kandidatëve e datës 22.12.2022 e lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Përmbledhja
e vlerësimeve individuale e datës 22.12.2022 e lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës;
Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i
Kosovës; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 16.12.2022 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit
Gjyqësor i Kosovës; Vendimin KA.nr.05/2023 me numër protokoll 01/269 i datës 21.02.2023 të
lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Propozim për emërimin e KPSHC-së me numër
protokoll 14.12.2022 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Përcaktimi i kriterëve
për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 16.12.2022 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i
Kosovës; Akt Emërimin me numër protokoll 03/598 të datës 18.09.2018 të lëshuar nga Sekretariati i
Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Akt Emërimin me numër protokoll 03/183 i datës 07.04.2014 i lëshuar
nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Akt Emërim me numër protokoll 03/295 i datës
22.09.2014 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Kontratë pune për kohë të caktuar
me numër protokoll 01/1093 i datës 29.07.2022 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i
Kosovës; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave e datës 16.12.2022 e S.S; Deklaratë për
mosekzistimin e konfliktit të interesave e datës 16.12.2022 e H.V; Deklaratë për mosekzistimin e
konfliktit të interesave e datës 16.12.2022 e A.H; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave
e datës 16.12.2022 e Z.P; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave e datës 16.12.2022 e F.B;
Vlerësimi i testimi me shkrim i datës 19.12.2022 dhe testimi me gojë i datës 22.12.2022 i kandidatës
F.K nga të gjithë anëtarët me korrespondim prej faqe 1-5; Testi me shkrim i kandidatës F.K me
korrespondim prej faqe 1-10; Kërkesë për punësim me numër protokoll 44 të datës 20.06.2022 të
kandidatës F.K; Certifikatë me numër 316 e datës 21.10.2019 e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë për
F.K; Vërtetim i datës 20.06.2022 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për F.K; Ndryshim dhe
Plotësim i Akt Emërimit i datës 29.05.2018 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për F.K; Akt
Emërim me numër 03/112-322 i datës 28.12.2012 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i
Kosovës për F.K; Vërtetim me numër protokoll 170/2015 i datës 17.06.2015 i lëshuar nga Shkolla
Filllore dhe e Mesme e Ulët Vërtetim i datës 10.10.2000 i lëshuar nga
për F.B; Certifikatë e datës 14.12.2007 e lëshuar nga "PRONET" për F.B;
Certifikatë e periudhës Prill-Qershor 2009 e lëshuar nga "USAIDI" për F.B; Certifikatë e datës
21.09.2009 e lëshuar nga "PRONET" për F.B; Certifikatë e datës 30.10.2013 e lëshuar nga "USAIDI"
për F.K; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 13.01.2022 i lëshuar nga Sekretariati i
Këshillit Gjyqësor i Kosovës për F.K; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 14.01.2021
i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës për F.K; Certifikatë me numër 3611/2022 e
datës 15.06.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për F.K; Rekomandim i datës 17.06.2022 i
lëshuar nga Gjyqtarja M.A për F.K; Rekomandim i datës 17.06.2022 i lëshuar nga Gjyqtarja F.Q për
F.K; Kopje e Letërnjoftimi e F.K; Diplomën me numër 43/2015 të datës 06.08.2015 të lëshuar nga
Kolegji "Gjilani"-Programi Juridik për F.K; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare me numër

protokolli 03/2318 të datës 27.12.2022 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Raporti Final i Rekomandimit i datës 22.12.2022 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 22.12.2022 e lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e datës 22.12.2022 e lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 16.12.2022 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Propozim për emërimin e KPSHC-së me numër protokoll 03/2254 i datës 14.12.2022 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vlerësimi i testimit me shkrim i datës 19.12.2022 dhe testimit me gojë i datës 22.12.2022 i kandidatës F.D nga të gjithë anëtarët me korrespondim prej faqe 1-5; Kërkesë për punësim me numër protokoll 37 të datës 17.06.2022 të kandidatës F.D; Diplomë me numër 17/2018 e datës 21.07.2018 e lëshuar nga Kolegji "ARBËRI"-Programi Juridik i Përgjithshëm për F.H-D; Certifikatë e periudhës Maj-Korrik 2016 e lëshuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës për F.D; Certifikatë e datës 04.06.2013 e lëshuar nga "USAIDI" për F.D; Certifikatë e datës 21.09.2009 e lëshuar nga "USAIDI" për F.D; Certifikatë e datës 16.03.2009 e lëshuar nga Akademia e Drejtësisë për F.D; Certifikatë e datës 14.12.2007 e lëshuar nga "PRONET" për F.D; Shkresë Emërim i lëshuar nga Struktura e Përbashkët e Përkohshme Administrative e Kosovës-Departamenti i Drejtësisë-Komuna e Gjilani-Gjykata e Qarkut me datë 01.03.2001 për F.D; Vendimin me numër reference DS-439/2022 të datës 07.04.2022 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për F.D; Certifikatën me numër 3544/2022 të datës 14.06.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për F.D; Kopje e Letërnjoftimit e F.D; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 15.01.2021 për F.D; Rekomandim i lëshuar nga V.K me datë 20.06.2022 për F.D; Referencë e lëshuara nga V.S-RR me datë 18.06.2022 për F.D; Testi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-9; ; Vlerësimi i testimit me shkrim i datës 19.12.2022 dhe testimit me gojë i datës 22.12.2022 i kandidatit SH.H nga të gjithë anëtarët me korrespondim prej faqe 1-5; Testi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-9; Kërkesë për punësim me numër protokoll 28 të datës 20.06.2022 e kandidatit SH.H; Akt Emërim me numër protokoll 301/17 i datës 19.09.2017 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për SH.H; Vendim me numër protokoll 115/17 të datës 01.03.2017 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për SH.H; Akt Emërim me numër protokoll 03/405 të datës 28.02.2022 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për SH.H; Rekomandim i datës 17.06.2022 i lëshuar nga N.I për SH.H; Certifikatë me numër 1034/2022 e datës 16.06.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore për SH.H; Kopje e Letërnjoftimit e SH.H; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 09.01.2020 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për SH.H; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 14.01.2022 i lëshuar nga nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për SH.H; Certifikatë e datës 31.05.2014 e lëshuar nga Kolegji "FAMA" për SH.H; Diplomë me numër 411/0415 i datës 27.04.2015 i lëshuar nga Kolegji "FAMA"-Bachelor i Arteve në Kriminologji për SH.H; Diplomë me numër 1131/0619 e datës 19.06.2019 të lëshuar nga Kolegji "FAMA"-Programi Juridik për SH.H; Rekomandim i datës 17.06.2022 i lëshuar nga SH.D për SH.H; Vlerësimi i testimit me shkrim i datës 19.12.2022 dhe testimit me gojë i datës 22.12.2022 i kandidatës F.A nga të gjithë anëtarët me korrespondim prej faqe 1-5; Testi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-9; Kërkesa për punësim e datës 20.06.2020 parashtruar nga kandidatja F.A; Akt Emërim me numër protokoll 103/17 i datës 22.02.2017 i lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit për F.A; Diplomë me numër 4485 e datës 25.01.2017 e F.H-Z; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.01.2021 i lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për F.A; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.06.2022 i lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për F.A; Rekomandim i Gjyqtarit R.A për F.A; Certifikatë me numër 3687/2022 i datës 20.06.2022 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për F.A; Kopje e Letërnjoftimit e F.A; Rekomandim i Gjyqtarit B.Y për F.A; Vlerësimi i testimit me shkrim i datës

19.12.2022 dhe testimi me gojë i datës 22.12.2022 i kandidatit N.K nga të gjithë anëtarët me korrespondim prej faqe 1-5; Testi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-9; Kërkesa për punësim e datës 17.06.2022 e parashtruar nga kandidati N.K; Kopje e Letërnjoftimit e N.K; Akt Emërim me numër protokoll 03/112-383 i datës 28.12.2012 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës për N.K; Akt Emërim me numër protokoll 326/17 i datës 27.10.2017 i lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit për N.K; Vendim me numër protokoll 317/17 i datës 20.10.2017 i lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit për N.K; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 13.01.2021 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për N.K; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 05.01.2022 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për N.K; Certifikatë me numër 3565/2022 e datës 14.06.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për N.K; Diplomë e lëshuar nga Shkolla për Trajnimin me Kompjuter "Ardhmëria" për N.K; Certifikatë e datës 05.02.2002 e lëshuar nga Qendra Rinore për N.K; Certifikatë e datës 12.04.2021 e lëshuar nga Akademia e Drejtësisë për N.K; Certifikatë e datës 23-24.09.2021 e lëshuar nga Akademia e Drejtësisë për N.K; Certifikatë e datës 27-28.10.2017 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe "QASJE" për N.K; Certifikatë e viti 2017 e lëshuar nga Regional Conference Director for Prishtina për N.K; Diplomë me numër 719/1218 e datës 01.12.2018 e lëshuar nga Kolegji "Fama" për N.K; Diplomë me numër 466/0716 e datës 14.07.2016 e lëshuar nga Kolegji "Fama" për N.K; Vlerësimi i testimi me shkrim i datës 19.12.2022 dhe testimi me gojë i datës 22.12.2022 i kandidatit E.H nga të gjithë anëtarët me korrespondim prej faqe 1-5; Kërkesa për punësim e datës 20.06.2022 e parashtruar nga kandidati E.H; Testimi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-9; Akt Emërim me numër protokoll 03/306 i datës 06.11.2014 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për E.H; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti I Prishtinës-Fakulteti Juridik për E.H; Kopje e Letërnjoftimit e E.H; Certifikatë me numër 3665/2022 e datës 16.06.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për E.H; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.01.2021 i E.H; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 14.01.2022 i E.H; Rekomandim i datës 17.06.2022 i Gjyqtarës L.SH për E.H; Rekomandim i datës 17.06.2022 o Gjyqtarit R.S për E.H; Testi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-10; Kërkesa për punësim me numër protokoll 34 e datës 20.06.2022 e parashtruar nga kandidati A.A; Kopje e Letërnjoftimit e A.A; Certifikatë e datës 31.05.2019 e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Trajnime për A.A; Certifikatë e datës 02-10.03.2006 e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për A.A; Certifikatë e lëshuar nga Qendra Rinore IRC për A.A; Certifikatë e lëshuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës për A.A; Certifikatë e periudhës 27.05-14.06.2013 e lëshuar nga "USAIDI" për A.A; Certifikatë e muajit Shtator 2013 e lëshuar nga "USAIDI" për A.A; Certifikatë e muajit Shtator 2013 e lëshuar nga "USAIDI" për A.A; Certifikatë e datës 04.06.2013 e lëshuar nga "USAIDI" për A.A; Certifikatë e periudhës Prill-Korrik 2009 e lëshuar nga "USAIDI" për A.A; Certifikatë e datës 21.09.2009 e lëshuar nga "PRONET" për A.A; Certifikatë e muajit Tetor 2009 e lëshuar nga "USAIDI" për A.A; Certifikatë e datës 14.12.2007 e lëshuar nga "PRONET" për A.A; Certifikatë e datës 11-12.11.2004 e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për A.A; Certifikatë e datës 28.04.2001 e lëshuar nga Qendra Rinore IRC për A.A; Diplomë me numër protokoll 960 të datës 07.10.1999 e lëshuar nga Gjimnazi "Zenel Hajdini" për A.A; Diplomë me numër 29/2016 e datës 06.09.2016 e lëshuar nga Kolegji "Gjilani" për A.A; Referencë e datës 18.12.2020 e Gjyqtarit A.SH për A.A; ID me numër KGJK-1158 e A.A; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit me numër protokoll 196/2018 i datës 29.05.2018 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për A.A; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 07.01.2021 për A.A; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 13.01.2022 për A.A; Testimi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-9; Testimi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-10; Kërkesa për punësim me numër protokoll 26 e datës 20.06.2022 e parashtruar nga kandidatja M.T; Diplomë me numër 28/2016 të datës 06.09.2016 e

lëshuar nga Kolegji "Gjilani" për M.T; Akt Emërim me numër protokoll 02/2019 i datës 03.01.2019 i
lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për M.T; Vendim me numër protokoll 03/865 i datës
29.07.2015 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për M.T; Certifikatë e datës
14.12.2007 e lëshuar nga "PRONET" për M.T; Certifikatë e datës 24.10.2013 e lëshuar nga "USAIDI"
për M.T; Certifikatë e datës 24.09.1198 e lëshuar nga "ASK Technology Computers" për M.T;
Certifikatë e datës 17.05.2016 e lëshuar nga Ministria e Financave për M.T; Formulari për vlerësimin e
rezultateve në punë i datës 19.01.2021 për M.T; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës
17.01.2022 për M.T; Rekomandim i datës 16.06.2022 i Gjyqtarit N.M për M.T; Rekomandim i datës
16.06.2022 i Zyrtarit të Lartë për Buxhet dhe Financa S.Q për M.T; Certifikatë me numër 3664/2022 e
datës 17.06.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për M.T; Kopje e Letërnjoftimit e M.T;
Testi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-9; Testi me shkrim me korrespondim prej faqe 1-10;
Kërkesa për punësim me numër protokoll 23 e datës 20.06.2022 e parashtruar nga kandidatja XH.B;
Diplomë me numër 258/0614 e datës 17.06.2014 e lëshuar nga Kolegji "FAMA" për XH.B; Shkresë;
Certifikatë e datës 29.10.2001 e lëshuar nga "BEYOND 2000" për XH.B; Akt Vendim me numër
protokoll 04.29/90 i datës 26.03.1990 i lëshuar nga Gjykata Komonale e Gjilanit për XH.B; Akt Emërim
i datës 28.02.2022 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për XH.B; Kopje e
Letërnjoftimit e XH.B; Vërtetim me numër 7350/035 i datës 20.09.2002 i lëshuar nga Kuvendi Komunal
i Gjilanit për XH.B; Rekomandim i lëshuar nga Gjyqtarja K.H për XH.B; Referencë e datës 17.06.2022
e lëshuar nga Gjyqtarja M.A; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.01.2022 për
XH.B; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.01.2021 për XH.B; Vërtetim i datës
20.06.2022 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për XH.B; Kërkesa për punësim me numër
protokoll 24 e datës 20.06.2022 e parashtruar nga kandidatja XH.B; Certifikatë me numër 36663/2022
e datës 16.06.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për XH.B; Akt Emërim me numër
reference 03-112-305 i datës 28.12.2012 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për
XH.B; Kopje e Letërnjoftimit e XH.B; Referencë e datës 17.06.2022 e lëshuar nga Gjyqtarja M.A për
XH.B; Vërtetim i datës 20.06.2022 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan për XH.B; Testi me shkrim
me korrespondim prej faqe 1-9; Kërkesa për punësim me numër protokoll 61 e datës 20.06.2022 e
parashtruar nga kandidatja Z.R; Diplomë me numër 1225 e datës 30.05.2018 e lëshuar nga Universiteti
i Prishtinës "Hasan Prishtina" për Z.R; Vërtetim i Kopjes nga Origjinali me LRP.Nr.1904/2019;
Diplomë me numër 16/2016 e datës 05.09.2016 e lëshuar nga Kolegji "FAMA" për Z.R; Vërtetim i
Kopjes nga Origjinali me LRP.Nr.1905/2019; Certifikatë me numër 1897 e datës 06.12.1999 e lëshuar
nga SHLP "Skënderbeu" në Gjilan për Z.R; Akt Emërim me numër reference 03-112-306 të datës
28.12.2012 i lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Z.R; Certifikatë me numër
3688/2022 i datës 20.06.2022 për Z.R; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.01.2022
për Z.R; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.01.2021; Rekomandim i datës
15.06.2022 i lëshuar nga Gjyqtari N.M për Z.R; Letër reference e datës 15.02.2022 e lëshuar nga Gjyqtari
S.B për Z.R si dhe Vendimin VK/2023 të datës 05.05.2023 nga Këshilli lidhur me vazhdimin e afatit të
ankesës së ankuesve.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë,
konstatoi se ankesa e ankuesve

është e pa bazuar, sepse:

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill pretendojnë se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil
nuk është konform Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, konkretisht
nenit 7 paragrafin 5 nën paragrafin 5.4 për shkak se nga institucioni-Gjykata Themelore në Gjilan, në
të cilin duhet të plotësohen dy (2) pozitat nuk kanë qenë asnjë anëtar i komisionit nga ky institucion,

nuk janë saktësuar pozitat e anëtarëve, të njëjtit po ashtu pretendojnë se komisioni përzgjedhës gjatë intervistimit të kandidatëve ka qenë i anshëm, nuk ka vendosur sipas meritës e sidomos për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika duke e bërë konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të njohurive të kandidatëve .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave fillimisht ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesve lidhur me atë se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil nuk është konform Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, konkretisht nenit 7 paragrafit 5 nën paragrafit 5.4 për shkak se nga institucioni-Gjykata Themelore në Gjilan, në të cilin duhet të plotësohen dy (2) pozitat nuk kanë qenë asnjë anëtar i komisionit nga ky institucion, e po ashtu në vendim nuk janë saktësuar pozitat e anëtarëve dhe ndërlidhur me këtë ka konstatuar se me datën 13.12.2022 Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka nxjerrë Vendimin me numër të referencës DS-1242/2022, sipas të cilit ka emëruar Komisionin Përzgjedhës lidhur me pozitat e shpallura ndër to edhe për pozitat të cilat janë objekt shqyrtimi i kësaj ankese, e në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si në vijim: A.H në pozitën si Drejtor i Departamentit Ligjor/SKGJK-Kryesues i komisionit, S.S në pozitën si Administrator në Gjykatën Themelore në Ferizaj-anëtar i komisionit, B.B në pozitën si Udhëheqës i Zyrës për Evidencë Penale/SKGJK-anëtar i komisionit, H.V në pozitën si Udhëheqës i ZML në Gjykatën Themelore në Gjakovë- anëtar i komisionit dhe Z.P në pozitën si Ndihmës administrator në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë- anëtar i komisionit e në të cilin vendim janë të precizuara edhe pozitat e anëtarëve të komisionit në fjalë, si dhe lidhur me emërimin e anëtarëve të komisionit në fjalë e që lidhet me pretendimin ankimor të ankuesve, Kolegji konstaton se bazuar në Udhëzimin Administrativ (NR.01/2019) për Ndarjen e Përgjegjësive të SKGJK dhe të Gjykatave në Çështjet e Personelit, Buxhetit dhe Financave, Logjistikës dhe Prokurimit sipas nenit 3 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të të njëjtit udhëzim precizohet se Zyra e Burimeve Njerëzore e SKGJK-së është përgjegjëse për: " *aprovimin e procedurave të rekrutimit në SIMBDNJ, shpalljen e konkurseve, propozimin për themelimin e komisioneve për rekrutim/pranim, zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe emërimin e të gjithë punonjësve mbështetës në pajtim me legjislacionin në fuqi*", e që nisur nga ky kontekst me që zhvillimi i procedurave të rekrutimit për punonjësit brenda gjykatave të Republikës së Kosovës, kryhet nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës sipas këtij udhëzimi atëherë edhe emërimi dhe caktimi i anëtarëve të komisionit për procedurat e rekrutimit në fjalë është në kompetencë të SKGJK-së e që i bie nga organi punëdhënës, prandaj edhe pretendimet ankimore të ankuesve në këtë drejtim janë të pabazuara dhe të pa qëndrueshme.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se për pozitën e punës Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika në Gjykatën Themelore në Gjilan si kritere themelore të përcaktuara kanë qenë: *Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë-Fakulteti Juridik, Së paku tri (3) vite përvojë pune*, ndërsa për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjilan si kritere themelore të përcaktuara kanë qenë: *Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë-Fakulteti Juridik, Së paku tri (3) vite përvojë pune*. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës është konstatuar se kandidatet e përzgjedhura kanë plotësuar kriteret e konkursit, ngase Kolegji i Këshillit ka gjetur se për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika kandidatja e përzgjedhur me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me numër 17/2018 të datës 21.07.2018 të lëshuar nga BPAL-PHEI-Kolegji Arbëri në Gjilan me të cilën dëshmohet se e njëjta me datën 13.07.2018 ka përfunduar studimet në programin Juridik i Përgjithshëm dhe me këtë rast ka marrë titullin LLB në Juridik i Përgjithshëm ndërsa ndërlidhur me përvojën e njëjta ka dorëzuar Shkresën e emërimit të datës 01.03.2001 të lëshuar nga Strukturat e Përbashkët e Përkohshme Administrative e Kosovës, Komuna e Gjilanit-Gjykata e Qarkut për vendin

e punës si Daktilografe si dhe Vendimin me numër reference DS-439/2022 të datës 07.04.2022 të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së sipas së cilit te njëjtës nga pozita si Sekretare Juridike në bazë të Akt emërimit të datës 28.12.2012 me koeficient 6 në Gjykatën Themelore në Gjiilan i është harmonizuar pozita dhe paga me pozitën Zyrtar ligjor me koeficient 7. Ndërsa lidhur me pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjiilan kandidatja e dytë e përzgjedhur me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me numër 43/2015 të datës 06.08.2015 nga BPAL-PHEI-Kolegji Gjilani në Gjiilan me të cilën dëshmohet se e njëjta me datën 15.07.2015 ka përfunduar studimet ne programin Juridik i Përgjithshëm dhe me këtë rast ka marrë titullin LLB në Juridik , ndërsa sipas Certifikatës me numër Nr.316/2019 të datës 21.10.2019 të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, rrjedh se e njëjta ka përfunduar provimin e Jurisprudencës me datën 21.10.2019. Ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta ndër të tjera ka dorëzuar edhe vërtetimin e datës 20.06.2022 të lëshuar nga Administratorja e Gjykatës Themelore në Gjiilan, me të cilën dëshmohet se e njëjta nga data 01.03.2000 deri ne vitin 2004 ka punuar ne pozitën e përkthyeses se gjuhës angleze në ish Gjykatën Komunale në Gjiilan, ndërsa nga viti 2004 e deri ne prill të vitit 2018 ka punuar në pozitën e Referentes në po të njëjtën gjykatë kurse nga data 29.05.2018 në pozitën e Referentes së lartë. Kështu që duke ju referuar provave të administruara si më lartë, Kolegji i Këshilli konstaton se të dy kandidatet e përzgjedhura i kanë plotësuar kriteret e konkursit në kuptim të kualifikimit dhe përvojës së kërkuar të punës, dhe si rrjedhojë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin përfshirjes së tyre në listën e shkurtër ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 ku përcaktohet se: *“1. Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës”*.

Kolegji i Këshillit bazuar në provat e lëndës, respektivisht formularin e datës 26.10.2022, 28.10.2022 dhe 03.11.2022 lidhur me përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Komunën e Gjilanit ka gjetur se kandidatja e përzgjedhur sipas përmbledhjes së vlerësimeve individuale ka grumbulluar gjithsejtë 374.75 pikë, ndërsa për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika kandidatja e përzgjedhur ka mbledhur gjithsejtë 377.25 pikë, ndërsa ankuesit në fjalë sipas përmbledhjeve të vlerësimeve individuale në testin me shkrim dhe intervistën me gojë kanë mbledhur më pak pikë dhe janë ranguar më poshtë bazuar në rezultatet përfundimtare të arritura, nga rrjedh se kandidatet e përzgjedhura kanë arritur më së shumti pikë duke u renditur me numër rendor 1 në listat e kandidatëve të suksesshëm. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i testit me shkrim është konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka vepruar në pajtim me nenin 37, 38 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe nuk është vërejtur ndonjë shkelje procedurale ngase të gjithë kandidatëve i është dhënë mundësia e barabartë për t’iu nënshtruar të gjitha procedurave të rekrutimit, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe se pretendimi ankimor i ankuesve në këtë kuptim është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve se testi me shkrim nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga Komisioni Përzgjedhës, duke ju referuar kështu pjesës se tretë të testit me shkrim-Njohurive që lidhen me vendin e punës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se testi me shkrim për pozitën e lartcekura të mbajtura me datë 19.12.2022 ka qenë i përpiluar në pajtueshmëri me nenin 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi që pjesa e parë e

testit me shkrim qe ka të bëje me njohuritë e përgjithshme është përberë nga tre (3) ese, pjesa e dytë e testit me shkrim qe ka të bëjnë me aftësitë e përgjithshme dhe të personalitetit, është përberë nga dhjetë (10) pyetje me përgjigje të shumëfishta, si dhe pjesa e tretë e testit me shkrim qe ka të bëje me njohuritë e vendit të punës është përberë nga gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje, prej tyre gjysma me përgjigje të shumëfishta dhe gjysma në formë eseje të shkurtra ku gjatë analizimit të testit me shkrim të ankuesve dhe të kandidatëve të përzgjedhura nuk është vërejtur ndonjë parregullsi e cila mund ta ketë favorizuar respektivisht dëmtuar ndonjërin nga kandidatët në procedurë rekrutimi, kështu që në rrethanat e rastit konkret Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nenin 36 paragrafit 2, ku përcaktohet se: *“Kandidatët të cilët kalojnë me sukses testin me shkrim ose arrijnë të mbledhin 50% të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë”*, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Komisioni Përzgjedhës me rastin e rekomandimit të kandidatëve të suksesshme në fjalë lidhur me pozitën e lartcekura për emërim në shërbimin civil, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 40 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë”*.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika dhe Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjilan nga një (1) pozitë, është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse ankuesve nuk i është cenuar asnjë e drejtë në këtë proces, rrjedhimisht Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e zhvillimit të këtyre procedurave ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore. Ndërsa, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr.05/2023 të datës 21.02.2023, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.563/2023, datë 24/05/2023.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së ankuesve,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.